

JULIÁN
CARRÓN
ZHGJIMI
I NJERIUT

*Refleksione në kohë
të Coronavirusit*

Julián Carrón

Zhgjimi i njeriut

Refleksione në kohë
të Coronavirusit

Redaktuar nga Alberto Savorana

© 2020 Vellazeria Bashkim dhe Lirim

Edizioni Italian: BUR Rizzoli, Milano, Prill 2020 (e-book),

Qeshor 2020 (paperback)

Zhgjimi i njeriut

Brenda pak javësh emergjenca shëndetësore e provokuar nga Covid-19 u bë një përvojë e përgjithëshme. Të gjithë, në role të ndryshme, jemi ndjerë të Thirrur. Paradoksalisht, rrethanat e izolimit në të cilat jemi gjetur u bënë mundësi e një dialogu të jashtëzakonshëm në distancë.

Secili, në një mënyrë ose tjetër, është duke u munduar të matet me një të dhënë të parashikuar që ka vërshuar jetën tonë të përditëshme, duke imponuar një ndryshim drastik në stilin e jetës, duke nxitur pyetje urgjente që nuk mund t'i injorojmë. Cilat përgjigje janë në nivel të situatës?

Don Julián Carrón, president i Vëllazërisë Bashkim dhe Lirim, është duke u përballur me pyetjet e të gjithëve. Dhe në këtë faqe ofron një kontribut të rëndësishëm në reflektimin e përbashkët.

Çfar po ndodhë?

Ne po përballemi me një sfidë të paparë për gjeneratën tonë. Ne *ElPaís* poeti spanjoll Julio Llamazares, e ka sintetizuar shume mirë: këtë gjë «Sot po i mbushi 50 vjet, në momentin më kritik që kam njohur ndonjëherë».¹

Situata të cilën po jetojmë na ka vetëdijesuar se ne këto vite në njëfarë forme kemi jetuar në një fluske, që na ka bërë të ndjehemi të strehuar nga goditjet e jetës. Dhe kështu kemi vazhduar të shpërqendruar, duke pretenduar se gjithçka ishte nën kontrollin tonë. Por rrethanat e tanishme kanë prishur planet tona dhe na kanë thirrur në mënyrë të vrazhdë që t'ju përgjigjemi, ta marrim seriozisht unin tonë e të pyesim vetën për gjendjen tonë ekzistenciale. Këto ditë realiteti e ka tronditur përditshmërinë tonë pak a shumë të qetë

¹ *El País*, 28 mars 2020.

duke marrur pamjen kërcënuese të Covid-19, një virus i ri, që ka provokuar një emergjencë shëndetësore ndërkombëtare.

Realiteti, nga i cili shpesh ikim që të marrim frymë, nga paaftësia që të qëndrojmë me vetën tonë, këtë herë është i ashpër, duke detyruar shumicën prej nesh që të rrijmë mbyllur në shtëpi, të ndalemi. Dhe në këtë izolim është duke dalë në pahë para syve tonë – mbase për herë të parë në mënyrë kaq të dukshme dhe të përhapur – gjendja jonë ekzistenciale. Ndërsa lexoja vite më parë në një gazetë amerikane si, një i burgosur, i detyruar të përballet më shume vite të privimi nga liria, në fund nuk kishe mundur të shmangte faktin se duhet të ndalej dhe të mendonte: «Stop and think». Edhe ne, të mësuar që të ikim në mijëra mënyra nga vetja jonë dhe nga thirrja e thellë e gjërave, në këtë kohë ndoshta nuk kemi qenë në gjendje të ndalemi dhe të mendojmë.

Cfar e beri te shperthej «flusken» e një jete nën kontroll?

Thyerje e papritur dhe e paparashikueshme e realitetit, me fytyrën e Coronavirus-it. E përshkruan në mënyrë efektive romancie-

ri spanjoll José Ángel González Sainz: «Në jetën e një vendi ose të një personi, janë disa momente në të cilët realiteti konkret dhe objektiv, me pak i përpunuar dhe i kalitur nga recetat dhe kuzhinierë të mësuar të gatuajnë mentalitete e histori, ndërprehet papritmas me një dhunë të frikshme me të cilën nuk ishëm mësuar. Realiteti nuk bëhet real në atë moment, ka qenë gjithmonë real, ishte aty që në fillim, por butësia e tij na ka lejuar që mos ta shikojmë vazhdimisht ballafaqesh; ishte e mjaftueshme që ta shikonim me bisht të syrit e të koncentrohemi në historitë dhe iluzione që do të na servoheshin, pak a shumë të pëlqyeshme ose të rrëjshme. [...] kur ajo që është thelbësore dhe e padiskutueshme, që i mbanë të gjitha, shpërthen papritmas dhe përhapet duke dalur nga kontrolli – ose nëpërmjet frikës– të pjesës iluzore të jetës sonë, vizioni i iluzionit në të cilin kemi jetuar, dhe nga i cila e kemi parë realitetin, dridhet. Kjo është ajo që po ndodh tani, kudo».

Ajo që ka ndodhë është si një termet nën-ujor, një shpërthim vullkanik, që na ka gjetur të pafuqishëm. González Sainz vazhdon duke zbuluar motivin (arsyen) e kësaj dobësie: «Shprehija e të zëvendësuarit të gjërave dhe fakteve me përdorimin e tyre strategjik mashtrues; realitetin me idelogjinë, të vërt-

etën me pandëshkueshmërinë e mashtrimit dhe thelbësoren me banalitet, ne na vë në gjëndjen më të keqe për t'u përballuar me hakmarrjen e vërtetë të realitetit».² Realiteti është rrebeluar për shkak se kemi refuzuar ta njohim, tani papritmas po kërkon rolin e tij “primar”. Ashtu siç shkruan Fernando De Haro, një mike gazetare e një radio spanjolle, duke i bërë jehonë romancierit të lartëcituar: «Realiteti [...] ishte aty por ne nuk e kemi parë. Tani ai është kthyer me zë të lartë. [...] Realiteti ka hyrë pa kërkuar leje. [...] Tani ajo çka ne kemi nevojë të bëhemi të vetëdijshëm është “ se thellësia e realitetit është thelbi i intelgjencës” (J.A. GonzálezSainz)».³

Po çfar do të thotë «”të bëjmë thellësinë e realitetit zemër të intelgjencës”»?

Do të thotë se vërshimi i fuqishëm i realitetit ka bërë që të rishfaqet në të gjithë përmasën e saj nevoja për të kuptuar atë që e quajmë «arsye». Nga një herë, nga vështirësitë e jetës ose nga përtesa, ndalojmë ecjen dhe ndalemi

² *El Mundo Viernes*, 20 marso 2020.

³ *ilsussidiario.net*, 24 marso 2020.

në dukjen e gjërave, sikur e gjithë bota mbaron në vendet e zakonshme ku frymojmë ose në atë që shohim nëpërmjet vrimës së çelësit të masës tonë matëse, racionaliste: një masë matëse e ngushtë, shumë e vogël, dhe në fund pastaj edhe mbytëse (pikërisht mbytja është spiuni që tregon se kemi mbetur te sipërfaqësorja. Vetëm impakti – i pranuar – me realitetin mund të kap përsëri arsyen. Është gjithmonë një kthim prapa (kundër goditje). Ka gjithmonë një reagim, të qenurit i goditur, gjë që bënë që sytë tanë të hapen: vetëdija implikon në burimin dhe në zhvillimin e saj një dimension origjinal afektiv. Sa më shumë një realitet na godet dhe na intereson, aq më shumë zhgjerohet vështrimi i arsyes, rritet, thellohet, nuk mjaftohet me zgjedhjet që ofron tregu i lirë. Gjërat shfaqen në kuptimin e tyre vetëm kur kanë një arsye afektive që i përfshinë.

Ndjenja se realiteti ngjallë habi, frikë, kuriozitet, është një faktor esencial (thelbësorë) për vizionin, është një “lentë” që e afron objektin. Kjo është ajo që ka ndodhur.

Ajo që ka ndodhur ka rizgjuar vëmendjen tonë, duke venë në lëvizje arsyen tonë, duke na çuar në njohje, përtej skemave komode, «se ka më shumë gjëra në tokë e në qiell, Orazio, se sa në filozofi», për ta thënë bashkë

me Shekspirin krejt këtë.⁴ Në këtë moment arsyeja rishfaqet si « ngjarje unike e natyrës në të cilën ajo del si nevojë operative për të shpjeguar realitetin me të gjithë faktorët e vet, kështu që njeriu të prezantohet me të vërtetën e gjërave».⁵

Tani e kuptojmë se pse përfunduam në fluskë. Për shumë kohë mbase kemi mundur që t'ja lejojmë vetës braktisjen e impaktit me realitetin – i cili nuk është ndalur asnjë herë, vazhdimisht ka ndodhur dhe na ka thirrur – ne nuk e kemi lejuar që të sfidohemi nga ia, ne besuam se e kishim zbutur atë, të mbrojtur nga një gjendje e privilegjuar e jetës. «Një individ që e ka jetuar pak impaktin me realitetin, pasi ka kapërcyer shumë pak vështirësi, ai e njeh pak vetëdijen e tij, e percepton me pak energjinë dhe vibrimin e arsyes së tij».⁶ Sot është, nuk po them e pa mundur – sepse nuk ka asgjë mekanike në përvojën njerëzore –, por sigurisht tmerrësisht e vështirë të shkëputemi nga realiteti, që është bërë kaq pashmangshmërisht dhe në mënyrë dra-

⁴ *Amleto*, atto I, scena V.

⁵ L. Giussani, *Il senso religioso*, Rizzoli, Milano 2010, pp. 133-134.

⁶ *Ibidem*, p. 139.

matike sfidues. Në çdo rast, kushdo që do t'i shpëtojë provokimit të realitetit, ngjarjeve, nuk do të mund të eksperimentoj deri në fund atë vibrim të pashprehur të arsyes ose të zemrës që na bënë njerëz. Dhe në javët e fundit kemi parë të ndodhin gjerësisht shenja të njerëzores që na kanë mbushur me mirënjohje dhe habi.

Çfar kuptohet me “vibrim të pashprehur të arsyes”?

Pyetjet nga të cilat të gjithë jemi sulmuar. Sfi-
da që realiteti na ka drejtuar, na ka “detyruar”
që të shohim më në thellësi qenien tonë
njerëzore. Jemi shkëputur nga *comfort zone*
në të cilën ishim akomoduar (sistemuar), dhe
të përshkruar nga pyetje që normalisht, në
mënyrë pak a shume të qëllimshme, i kemi
shmangur ose shuajtur (mbytur) në *routines*
e përditshme. E thekson Umberto Galim-
berti, duke ju përgjigjur një lexuesi: «Në si-
tuaten e pazakontë që gjindemi për shkak se
janë ndalur aktivitet tona të përditshme, në
këtë gjendje çorientimi, a nuk është rasti që
t'i drejtoheni brendësisë suaj, të cilën zakoni-
sht e neglizhoni, për të zbuluar se kush jeni?
Çarë jeni duke bërë në botë? Çfar kuptimi

ka jeta e juaj? [...]Këto reflektime do të ishin me të vërtetë një hap përpara për të qenë më të vërtet njerëz, sepse të jetosh pa vetëdije nuk është më e mira për vetë-realizimin e një personi dhe për të gjetur kuptim e ekzistencës tonë ».⁷ Çdo krizë, çdo thirrje e thellë e realitetit, ashtu siç na mëson Hannah Arendt, «na detyron të kthehemi te pyetjet»,⁸ e bënë unin tonë të shpërfaqet në të gjithë kuptimin e ekzistencës së tij, na bënë të bërtasim: pse?

Këto janë pyetje që na trazojnë, shqetësojnë, na detyrojnë të mendojmë për diçka që na ikë ...

Janë pyetjet e arsyes, që shoqërojnë strukturalisht ecjen e njeriut si krijesë e vetëdijshme. Ato tregojnë kërkimin radikal dhe të pashtershëm për një kuptim të unit përballë asaj që po ndodhë – realitetit, dhimbjes, vdekjes – dhe në të njëjtën kohë përputhmërinë e thellë të racionalitetit dhe religjiozitetit. Një rastësi që mund të befasoj këdo që është mësuar nga kultura jonë që të reduktoj religjiozitetin në ndjenja, a *feeling*. Qenësia e pyetjeve (çfarë

⁷ *D la Repubblica*, 21 mars 2020.

⁸ H. Arendt, *Ne mese te tashmes dhe te ardhemes*, Garzanti, Milano 1991, p. 229.

kuptimi ka ekzistenca? Pse ekziston dhimbja, vdekja? Pse në fund të fundit ja vlen të jetohet? Nga çfarë dhe për çfarë është bërë realiteti?) shpreh thirrjen e arsyes dhe asaj që unë e konsideroj si religjioziteti autentik e i pashmangshëm i njeriut.

Çfarë i është zbuluar arsyes në situaten aktuale?

Një struktur e brishtë – jo kontigjente ose e përkohëshme –, e shfaqur në të gjithë dramën e saj. Shumë kanë shkruar për të këto ditë. Dua të përmend këtu dy miq të mi më të dashur, Pilar Rahola dhe Pedro G. Cuartango, intelektualë të spikatur, njëri nga Barcelona dhe tjetri nga Madridi, që janë përballur me pandeminë që është duke gjunjëzuar edhe Vendlindjen time.

Rahola deklaron: « Tronditja që vije nga kjo pandemi do të na bëjë të ndjehemi, për shembull, shumë më të prekshëm (vulnerable) por më në fund të bindur se stili jonë i jetës, dhe vetë jeta, janë jashtëzakonisht të brishta. Një ide e brishtësisë që mbase ka qënë e pranishme në të gjithë historinë e njerëzimit, por që e kishim harruar në këto kohë të krenarisë teknologjike. Një virus i thjeshtë i gripit, është papritmas kaos në botë ... Po, pa

dyshim do të kthehemi me një vetëdije më të madhe dhe ndërgjegjësime më të madhe për cenueshmërinë tonë».⁹ Qe jemi të prekshëm nuk është një risi, por po ashtu kjo është një kusht që e gjejmë të qepur mbi ne që nga lindja jonë; e që në kohë të krenarisë teknologjike, ku gjithçka duket se është në duart tona, në një farë mënyrë ne e kishim harruar, e kemi lënë anash, duke humbur perceptimin se kush jemi. Ishte çarja e realitetit që na kthej përsëri vetëdijen për diçka që, shohim, është e dukshme por jo e qartë. «Kjo mur-tajë – nënvizon Pedro G. Quartango – na bënë të vetëdëshëm për brishtësinë e qenies njerëzore dhe sa thellësisht të parëndësishëm janë përballë forcave të natyrës që ne nuk i kontrollojmë. Le ta mbajmë këtë si një mësim të asaj që nuk jemi ».¹⁰

Në këtë kuptim, me duket konsekuent qendrimi i Jean-Pierre Le Goff, në *Le Figaro* ku thotë:

«Duhet të përballemi me tragjiken dhe jemi vu serish përballë kufijve tonë. “brishtësisë së gjërave njerëzore” [...]. Kjo kohë mund të jetë një mundësi për t’u përqëndruar në

⁹ *La Vanguardia*, 26 mars 2020.

¹⁰ *ABC*, 24 mars 2020.

gjërat thelbësore, për të kuptuar sfidat e kohës sonë. [...] thyerja që ka sjellur kjo epidemi [...] vë në pikëpyetje idetë dhe diskutimet që deri tani i merrnim për të mirëqena [...]. Jeta moderne duket se është e strukturuar në kundërshtim me idenë e Paskalit sipas të cilit “E gjithë pakënaqësia e njeriut rrjedh nga paaftësi e tij që të qëndroj vetëm në dhomën e tij”. [...] Epidemia na obligon që të përballemi me historinë tragjike pa boshllëqe. [...] na takon secilit prej neve që të nxjerrim mësimin e nevojshëm».¹¹

Përvoja e përtërirë e brishtësisë sonë na bashkon të gjithëve ...

Po, e kemi ndëgjuar ta thotë botërisht papa Francesco në sheshin e zbrazet të Shën Pjetrit natën e se premtës me 27 mars, në një mënyrë dhe me një intensitet që i la të gjithë në heshtje: «E kemi kuptuar që gjindemi në të njejtën barkë, të gjithë të brishtë dhe të hutuar [...]. Stuhia do ta demaskoj dobësinë tonë dhe do t'i lë të zbuluara krejt ato siguri të rrëme dhe të panevojshme me të cilat kemi ndërtuar planet tona, projektet, shprehitë dhe

¹¹ Përkthimi i botuar ne *Il Foglio*, 30 mars 2020.

prioritet tona. Ajo na dëshmon se si e kemi lënë të fjetur dhe të braktisur atë që ushqen, mbështet dhe i jep forcë jetës tonë dhe komunitetit tonë. Stuhia zbulon të gjitha synimet për të “paketuar” dhe për të harruar atë që e ka ushqyer shpirtin e popujve tanë; të gjitha ato përpjekje për të seduar me shprehi në dukje “shpëtimtare”, të pafta për të thirrur rrënjët tona dhe të kthejmë memorien e pleqëve tanë, duke na privuar kështu nga imuniteti i nevojshëm për t’u përballur me vështirësit. Me stuhinë, kanë rënë edhe truqet e atyre stereotipeve me të cilët maskonim “egot” tona gjithmonë të brengosur për imazhin tonë». Dhe në të njëjtën barkë Francesco na ka vendosur edhe neve, që jemi goditur nga stuhia, së bashku me të gjithë familjen njerzore dhe krejt krijimin: «Ne nuk jemi ndalur para thirrjeve tua, ne nuk jemi zgjuar përballë luftërave dhe padrejtësive planetare, nuk kemi dëgjuar britmën e të varfërve dhe te planetit tonë të sëmurë rëndë. Vazhduam të pakthyeshëm, duke menduar për të qëndruar gjithmonë të shëndetshëm në një botë të sëmurë. Tani, deri sa jemi në një det të trazuar, të përgjërrohemi: “Zgjohu o Zot!».¹²

¹² Francesco, *Moment i jashtzakonshem i lutjes*, 27 mars 2020.

*Po çfar fitojmë nëse e zbulojmë veten të brishtë,
të pambrojtur? Çfarë na shërben?*

Për të na larguar nga mpirja në të cilën jetojmë zakonisht, për të na a rrëmbyer nga shpërqendrimi në të cilin shpesh braktisemi gati pa e kuptuar, për të ndaluar mërzinë që aq shpesh na rrethon: «gjithçka komploton për të na bërë memecë, / pak a shumë si të heshtur / mbase nga turpi, pak a shumë si të heshtësh / shpresë e pashpirtë».¹³ Mirëpo nuk mjafton vetëm të zbulojmë veten të brishtë («Larg nga dega jonë, / Gjethe e gjorë, / Ku shkon ti?»),¹⁴ thoshte Leopardi). Vet perceptimi për brishtësinë tonë në fakt mbart me vete, si kusht të vetin, madhështinë e njeriut, « Mister i përjetshëm / I qenies sonë »: «Natyra njerëzore, ose si, / I gjorë në gjithçka dhe frikacak, / Nëse pluhur dhe hije je, kaq i lartë ndjehesh?».¹⁵ Akuza e kufirit, nga butësia, kuptimi i tragjikës implikon atë dëshiren

¹³ Cfr. R.M. Rilke, «Elegia II», vv. 42-44, in Id., *Elegie duinesi*, Einaudi, Torino 1978, p. 13.

¹⁴ G. Leopardi, «Imitazione», vv. 1-3, in Id., *Cara beltà...*, BUR, Milano 2010, p. 113.

¹⁵ G. Leopardi, « Mbi portretin e një gruaje të bukur të gdhendur në monumentin sepulkral të së njëjtës », XXXI, vv. 22-23, 49-51, in *Ibidem*, pp. 96-97.

për pafundësi që na definojnë si njerëz, edhe para se ne ta dimë. « Imagjinoni numrin e pafund të botëve, dhe universin e pafund, dhe të ndjejmë që shpirti dhe dëshira jonë do të ishte akoma më e madhe se vet universi ». ¹⁶ Asaj madhështie i përket edhe njohja e kontigjencës sonë: ne nuk e bëjmë vetën tonë, nuk jemi ne ata që e krijojmë qenien tonë. Ne thellësinë tonë dominon një varësi. Sot, ne në mënyrë të veçantë, kemi mundësi që të bëhemi më të vetëdishëm për këtë.

A, e ke vërejtur ndonjë shenjë të një “rifitimi” të vetëdijes?

Po, dhe kjo jo vetëm midis personaliteteve dhe shkrimtarëve nga të cilët është më e pritshme. Një mësues në pension na tregon përvojën e tij gjatë një iniciativ për të ndihmuar në mësimet nxënës të huaj: «Sot u pa një rreze drite brenda lajmëve gjithnjë e më alarmante mbi Coronavirusin. Po bënim një videolidhje me studentët tanë të *Portofranco* që ndjekin me neve kursin e gjuhës italiane. Janë vajza e djem të huaj, egjiptas dhe marokien», të çdo feje, madje edhe my-

¹⁶ G. Leopardi, «Pensieri», LXVIII, in *Poezi dhe proze*, Mondadori, Milano 1988, vol. II, p. 321.

slimanë. «Po flitnim se si jemi duke e jetuar këtë situatë: friken, shqetësimet, shkollën që nuk është më. Dhe në një moment, njëri nga ata tha kjo situatë vë në pahë kufirin e njeriut, dhe aty filloj një dialog mbi këtë temë. Një dialog që evidenton një lloj distance mbi atë se kush është Zoti, por në të njetën kohë del në pahë se ajo që na bashkon është të lindurit e një kuptimi brenda kësaj drame dhe pyetja se pse është një provë për të gjithë. Një dialog intenziv pa paragjykime, të gjithë duke u munduar të kuptojnë arsyet e njëri-tjetrit. Një dialog i lirë, në mes njerzish që janë duke e marrur seriozish atë që është duke u ndodhur dhe janë duke e jetuar si një verifikim i asaj që vlen në jetë».¹⁷

Jetojmë – quditërisht –një vështrim të gjerë të ekzistencës sonë me një imazh të rremë për vetën tonë, duke e vu në karantinë statusin tonë si njerëz. Dhe kjo na mbanë në gjendje anestezie. Shih për këtë Llamazares vëren: «Nëse kjo katastrofë shëndetësore duhet të na shërbej për diçka, atëherë ajo është për të na kujtuar brishtësinë e gjithçkaje, diçkaje që e harrojmë sapo të jetojmë disa vite në paqe dhe mirëqenie».¹⁸

¹⁷ Letra, «Me të gjithë, ne bashkëjetojmë të njejtën pyetje», clonline.org, 24 mars 2020.

¹⁸ *El País*, 28 mars 2020.

Cilat janë pasojat e mpirjes?

Ajo na lë të pafuqishëm përballë të papriturave të jetes. Ashtu siç shkruan González Sainz, «kur realiteti më i ashpër dhe real shpërthen me brutalitet si tani, kur distanca midis fakteve dhe tregimeve, nga emrat e objekteve dhe objektet e emrave, reduktohen deri ne minimum, të gjitha iluzionet e simuluarat, e gjithë makina infernale e gënjeshtreve dhe hipokrizisë, dhe e gjithë injoranca e kotë, mungesa e kujdesit, dhe aderimit të ngurtë ne realitetin dhe në kontrollin e menaxhimit të tij efikas, në kohë dhe në mënyrë efektive fitimprurëse, janë armët më të këqija për t'u përballur me të. Realiteti na gjen të pavetëdëshëm për gjithçka, të paarmatosur dhe të burgosur nga zakonet mendore më kundër produktive».¹⁹

«Realiteti më i egër dhe më i vërtetë shpërtheu me brutalitet ... ». Këto janë fjalë të zymta...

Realiteti nuk është duke na dhënë armëpushim. Siç ka shkruar Paolo Mieli me 3 prill, «në botë tanimë jemi një milion të infektuar.

¹⁹ *El Mundo Viernes*, 20 mars 2020.

Një milion, dhe e dimë se nuk do të ndalemi këtu. Gjysma e popullsisë së orbitës tokësore është e mbyllur brenda shtëpisë. Italia mban rekordin e te vdekurve

(13.915). E ndjekur nga Spanja që ka tejkaluar dhjetë mijë. Ne Bolonje vdiq i burgosuri i parë i shtrua në spital. Në Kinë ka pasur përleshje në urën e lumit Blu me agjentë Jiangxi të vendosur për të parandaluar tranzitinë e udhëtarëve nga Hubei, ku është shpallur fundi i bllokadës. Njëkohësisht u vu në izolim një rajon i Henanit i cili krahësohet me të një të Hubei. Në Hong Kong është shpallur karantina e dytë, pasi që është rishfaqur virusi për shkak të mos respektimit të distancës së sigurisë në restorante ».²⁰

Me përhapjen e virusit ne po e jetojmë realitetin si një ndryshim, të errët dhe të shurdhër në larminë e tij absolute: një prani e pa evitueshme, nga e cila ne varemi. Është imponuar, përtej gjdo reduktimi tonë, mbi-zotrimi i realitetit. Me Nicen ishim bindur se «nuk ekzistojnë fakte, por vetëm interpretime».²¹ Qëndrimi i tij, qe i ka rezistuar viteve

²⁰ *Corriere della Sera*, 3 prill 2020.

²¹ Cfr. F. Nietzsche, *Frammenti postumi 1885-1887*, in Id., *Opere*, Adelphi, Milano 1975, vol. VIII, fr. 7 (60), p. 299.

si një e vërtetë e pa diskutueshme, në një situatë si kjo tregon pikën e dobët, Realiteti, që dukej si diçka e tejkaluar, është kokë fortë dhe është duke e pushtuar skenën, po kthehet me forcë në plan të parë. Para syve tanë ka diçka më shumë se sa interpretime: ka fakte shumë të fuqishme, që kërkojnë të merren parasysh dhe madje të interpretohen në mënyrë adekuate. Nihilizmi është – se paku në këtë kuptim i varur në litarë.

Kokëfortësi e realitetit nuk na lë të qetë, edhe pse shumë herë preferojmë të mos e shohim, si atëherë kur, para disa javësh, kemi parë kamionët e ushtrisë që transportonin kufomat e të vdekurve tanë bergamask. Dhe pra, jo pa arsye, Domenico Quirico pyet: « A nuk është një detyrë kulturore që na imponon kjo histori që të pyesim për vdekjen me dinjitet dhe në heshtje,?». ²²

Realiteti rishfaqet në të gjithë misterin e tij. Ezio Mauro flet për « ankthe që lindin nga e panjohura, në një dimension të paarritshëm», ²³ në lidhje me të cilën ne ndertojme kufirin e aftësisë sonë për të mbizotëruar.

²² *La Stampa*, 5 prill 2020.

²³ *la Repubblica*, 11 mars 2020.

Dhe kur realiteti shfaqet në këtë mënyrë misterioze ai frymëzon frikë

Armiku me të cilin kemi të bëjmë nuk është vetëm Coronavirus, por në fakt është frika. Një frikë që ne gjithmonë e ndiejmë dhe akoma shpërthen kur realiteti e zhvesh pafuqinë tonë thelbësore, në shumë raste duke na bërë të reagojmë në mënyrë e zhëbën, duke na bërë që të mbyllemi, të dëshpërohemi. E ka thënë Ilvo Diamanti, gjithmonë i vëmendshëm ndaj zhvillimeve të shoqërisë sonë «Jetojmë në “kohën e frikës”. [...] Sepse pa-Siguria, pa-Qartësia, na shoqërojnë që shumë vite. Ndoshta, gjithmonë. [...] Kështu, frika ka hyrë në jetën tonë. Në botën tonë. Shumë më përpara se sa covid. [...] Larg nga të tjerët. Gjitmon e më të vetëmuar. [...] Rrezikojmë të humbim shpresën. Dhe vetveten ».²⁴ Por nënshtrimi ndaj frikës nuk është rruga e vetme.

Çfarë do të thuash?

Në momente si ky del në pahë rruga e pjekurisë që secili prej nesh në mënyre individuale, po edhe së bashku me të tjerët, e ka bërë, vetëdijen që e ka arritur për vetën, aftësia ose paaftësia

²⁴ *la Repubblica*, 9 mars 2020.

për të përballuar jetën që e ka në duar. Ideologjitë tona të mëdha ose të vogla, bindjet tona, madje edhe ato religjioze, janë vu ne provë. Guaska e sigurisë së rreme po tregon çarjet e saj. Dhe në rrethana si kjo në të cilën jemi zhytur tani e kuptojmë se «forca e njeriut qëndron në intensitetin e vetëdijes së tij, do të thotë perceptimi që ai ka për vlerat që e definojnë personalitetin e tij»,²⁵ në qartësinë me të cilën ai e percepton vetën dhe për çfarë ia vlen të jetohe.

Si është dhe çfarë do të thotë të qëndrojmë si njerëz përballë kësaj rrethane që, me apo pa dëshirën tonë, na përkeqëson gjithë, edhe pse në mënyra të ndryshme, kush në vijën e parë duke luftuar kundër sëmundjes (pacient, mjek dhe personeli shëndetësor), kush në sigurimin e shërbimeve esenciale (nga punonjësit e supermarketeve deri të forcat e rendit) kush duke ndihmuar ata që kanë nevojë (vullnetar, religjioz dhe shumë të tjerë) kush i mbyllur në shtëpi duke ju bindur rregullave të izolimit dhe të “distancimit social”?

Është një pikë që i bashkonë të gjithë e që është gadishmëria për të pranuar thirrjen që

²⁵ L. Giussani, *Ndjenja e Zotit dhe njerë modern*, BUR, Milano 2010, p. 132.

vjen nga realiteti. Si do qoftë, ne jemi në listë, pavarësisht nga detyra që na është besuar ose që kemi zgjedhur të kryejmë, çfarë ndodh - domethënë kjo pjesë e realitetit që na takon dhe shtërngohet rreth nesh - na sfidon, na thërret që të përgjigjemi. Nuk kemi një vend tjetër ku mund të kuptojmë kuptimin e jetës, si një fat; nuk kemi mënyrë tjetër për të ecur drejt përmbushjes përtej rrethanave në të cilat gjindemi. Kjo, po ja lejoj vetes të them, vlen për të gjithë. Në librin e tij më të njohur, *Kuptimi fetar*, don Giussani pohon: «I vetmi kusht për të qenë gjithmonë me të vërtetë religjioz është të jetoshë gjithmonë intenzivisht realitetin».²⁶ Konceptimi i tij i religjoizitetit që na shtyn të njohim çfarëdo rrethane si thirrje.

Rrethana, ajo që minut pas minuti na shqetëson dhe na provokon, është zbërthimi i një realiteti që nuk e bëjmë ne, që i referohet origjinës së tij përfundimtare, për diçka tjetër, përtej nesh, më e madhe se ne, për atë origjinë të pathyeshme që ne e quajmë Mister. Religjoziteti shfaqet si nje intuit e jetuar e Misterit, të kësaj papërballueshmërie enigmatike, në marrëdhëniet me çdo situatë të realitetit. Prandaj, Giussani thot, «te jetuarit e jetës si një thirrje do të thotë të ktheht te

²⁶ L. Giussani, *Ndjenja fetare*, op. cit., p. 150.

Misteri në për mjet rrethanave në të cilat [...] Zoti na bën të kalojmë, duke ju përgjigju atyre. [...] Thirrja është të shkojmë drejtë fatit duke përqafuar të gjitha rrethanat përmes të cilave fati na bën të kalojmë ».²⁷ Giussani ishte mire i vetëdijshëm për frikën që kjo sjellë në jetë «Njeriu, jeta racionale e njeriut do të duhej të pezullohej menjëherë, të pezullohet përball kësaj shenje kaq dukshëm të paqartë, rrethana kaq të rastësishme për mes të cilave “zotëriu” i pa njohur më tërheq, më provokon me planin e tij. Dhe të thenit “po” secilit moment pa parë asgjë, thjesht duke aderuar në presionin e rastit. Është një pozicion i frikës»²⁸ E kam të vështirë të gjej një shprehje më të përshtatshme për të përshkruar situatën në të cilën gjindemi kur realisht jemi përballë asaj që po ndodhë: që frikshëm të jemi të varur në secilin moment kësaj shenje kaq dukshëm të paqartë, kaq të rastësishme, e që janë rrethanat ». Dhe prapë – po them – ky është i vetmi qëndrim racional, sepse pikërisht për mes këtyre rrethanave Misteri, ai «zotëri “i pa njohur”», na thërret, na provokon në planin e tij misterioz, domethënë në përmbushjen e jetës.

²⁷ L. Giussani, *Realiteti dhe rinija. Sfida*, Rizzoli, Milano 2018, p. 65.

²⁸ L. Giussani, *Ndjenja fetare*, op. cit., p. 189.

Shpesh i ndiejmë rrethanat, disa rrethana, ekskluzivisht si pengesë për realizimin e vetvetës...

Kjo është një çështje e përhershme. Sot është izolimi nga Coronavirusi, ose një situat që mund të prezantohet akoma më e rende dhe impenjative, qeser do të jetë një situat tjetër, studimet, ose puna që bëjmë e që kurrë nuk do ta kishim zgjedhur, ose një sukses i munguar aty ku e kemi pritur, një refuzim afektiv, një mik ose një koleg i bezdisshëm, një sëmundje: gjithmonë do të ketë diçka që do të na duket si pengesë në realizimin e jetës sonë, derisa è – frikësuese në mënyrë dramatike – vendi në të cilin luhet përmbushja e jetës, raporti ynë me Misterin. Do të thoja, është, një çështje objektive, jo një zgjedhje. Zgjedhja është relative me njohjen ose jo të kësaj.

Carë mund të na mbështesë në këtë “frikë”?

Një miqësi njerëzore. Ose thënë më mirë një lloj miqësie njerëzore. Kjo përgjigje na qon drejtë një analize të jetës sonë sociale, për të parë se kush na ndihmë dhe kush është një shpërqendrim ne lidhje me frikën. Izolimi

është një rast paradoksal për të kuptuar cila miqësi e ushqen në thellësi ekzistencën tonë. E kam fjalën për një miqësi thelbësore, që nuk anestezon (paralizon) pyetjet që thërrasin brenda nesh, por përkundrazi na mbështet që t'i shohim në fytyrë pa ikur.

Cila do miqësi është ne provim, nga ky pike vështirim, të krishterë e laik, miqët e shkollës ose të fakultetit, në bar ose koleget e punës, në familje etj. Sa herë na ndodhë të bëjmë kompromise me nevojat tona dhe i ulim pritshmërit duke u mjaftuar me raporte që na mbrojnë nga rrethanat, na kursejnë nga sfidat e rrethanave, në vendë që të na shtyn që ti jetojmë ato! Por një miqësi e tillë nuk mund të jetojë deri në dramë: në momente si ato që po kalojmë, në të cilat nxitja për të jetuar bëhet e pashmangshme dhe e fuqishme, bëhet më e dukshme se kurrë.

Nëse frika na pushton, çfarë mund ta kapërcëjë atë?

Mbase përvoja më elementare që e kemi në lidhje me këtë është ajo e fëmijës. Çfarë e mund friken të një fëmijë? Prania e nënës. Kjo «metode» vlen për të gjithë. Është një prani, jo strategji e jona, intelegjenca jonë,

guximi ynë, ajo që mobilizon dhe mbështet jetën e secilit prej nesh. Një prani, memorie vepruese për veten.

Antonio Polito ka nenvizuar vlerën e metaforës së nënës me fëmijën pikrisht si përgjigje për friken kundër Coronavirusit: «Shoh nevojën për të pasur besim në diçka më tv madhe se ne, që na do pafundësisht dhe prandaj na mbron. Pikrisht ashtu si bëjmë kur jemi fëmijë»; dhe i referohet imazhit artistikë të Zojës së Mëshirshme, që «hap mantelin e saj dhe mbron popullin».²⁹

Dhe kur frika është ajo e errësirës së vdekjes?

Dinamika është po e njëjta, sepse njerëzorja ka ligjet e veta. Po përball frikës së thellë, e cila na mbërthen deri në thellësinë e qenies sonë e që përpiqemi ta largojmë sa më larg që është e mundur (frika nga vdekja dhe nga kumbimi e saj në jetë), duhet të pyesim cila prani është në gjendja ta mposhtë (fitoj). Jo çfarëdo prezence. Kjo është arsyeja pse Zoti u bë njeri, u bë një prani historike, njerëzore, e afërt, një mik udhëtimi. Vetëm Zoti që hynë në histori si njeri mund ta fitoj friken

²⁹ «Tracce-Litteraecomunionis», n. 4/2020, p. 15.

e thellë, siç ka dëshmuar (dhe dëshmon) jeta e dishepujve të tij, siç tregon Ungjilli. Për të bashkëndarë vuajtjen njerëzore Zoti u be njeri, «një njeri me emrin Jezus, nga Nazareti, i biri i Maris, qe [...]atë kohë në Nain, duke parë një nënë, të ve, qe shoqëronte arkivolin e djalit të vdekur në varr, ishte vërrshuar nga një emotion, duke i dalur përpare, kishe vu një rëndë dorë mbi supin e saj, dhe i kishte thënë: “Grua, mos qaj”, me një mospajtim të çuditshme. Dhe pasta ja ringjalli djalin. Por si mund t’i thuash një gruaje të ve, qe i ka vdekur djali: “Mos qaj”? Është absurde. E ne fakt ishte ky “absurditet” që i linte njerëzit me gojë hapura ». ³⁰ Kush e di se si është ndjerë ajo grua, e përshkruar nga një perqafim që tejkalonte çdo ndjenjë njerëzore dhe ja rikthente shpresën! Ajo vdekje nuk ishte fundi i gjithçkaje, ajo nënë e ve nuk ishte e dënuar qe të mbes vetëm, sepse fara e Ringjalljes ishte e pranishme në atë Njeri që i thoshte ato fjale të padëgjuaara dhe qe menjëherë ja kthen djalin të gjallë.

Cila është athër përgjigjja e krishterë në dramën e njeriut, të vetmisë, të dhimbjes, të sëmundjes,

³⁰ L. Giussani, S. Alberto, J. Prades, *Te gjenerojm gjurme ne historin e botes*, BUR, Milano 2019, p. 58.

ne situata që nuk kane përgjigje, si shumë nga ato që kemi parë shumë herë të ndodhinë në këto ditë?

Paul Claudelha në lidhje me këtë ka një vëzhgim përvëlues: «Një pyetje shfaqet vazhdimisht ne shpirtin e të sëmurit: “Pse? Pse mua? Pse duhet të vuaj?” [...]. Kësaj pyetje të tmerrshme, më antiken të Njerizimit, të cilës Giobbe i ka dhënë formën e saj pothuajse zyrtare dhe liturgjike, vetëm Zoti, drejtë për se drejtë i pyetur dhe i thirrur, ishte ne gjendej të përgjigjet, dhe çështja ishte aq e madhe sa vetëm Fjala mund të përballej me të, duke dhen jo nje shpjegim por nje prani, sipas këtyre fjalëve të Ungjillit: “Unë nuk kam ardhur të shpjegoj, që të largojë dyshimet me një shpjegim, por për të mbushur, ose me mire, për të zëvendësuar me pranin time vet nevojën për shpjegime”. Biri i Zotit nuk ka ardhur për të shkatërruar vuajtjen, por për të vuajtur me neve».³¹

Zoti nuk i është përgjigjur problemit të jetës, të vetmisë, të vuajtjes, me nje shpjegim, por me pranin e Tij: ai erdhi në botë për të na shoqëruar që ta jetojmë atë, u be sho-

³¹ *Toi, qui es-tu?*, Gallimard, Paris 1936, pp. 112-113; perkthim i yni.

qërues i njeriut ne cilen do situat qe gjindet, në mënyrë që njeriu të mund të qëndrojë para jush, për ta kaluar atë me një pozitivitet të pathyeshëm. Siç ka thënë Benedikti XVI në një predikim të famshëm, «vetëm ky Zot na shpëton nga frika e botës dhe nga ankthi përballë boshllëkut të vet ekzistencës sonë. Vetëm duke e shikuar Jezu Krishtin, gëzimi ynë ne Zotin arrin plotnin e vet, bëhet shëlbim».³²

Ju flisni për “pozitivitet të pathyeshëm”... Si është e mundur?

Le të mendojmë për gëzimin e gruas së ve, kur e sheh që i ktheht djali i saj i vetëm gjallë; një djalë i cili, herat a vone, do të vdiste përsëri, ashtu si edhe vet ajo. Problemi do të rishfaqej. Athëre metod për përvojen e shën Palit, kur, duke qenë në Romë në pranga, në pritje të nje gjykimi që do të mund të nënkuptonte vdekjen e tij, plot mirënjohje dhe gëzim, i shkruante Filipinaseve – që «mban ne zemër » dhe për të cilin ushqente «nje dashuri të madhe» – fjalë qe shumicës ju duke-shin absurde: «Per mua të jetuarit është Kri-

³² Benedikti i XVI, *Omelia*, Regensburg, 12 shtator 2006.

shti dhe vdekja një fitim». Si ishte e mundur? Ai e kishte parë Krishtin të gjallë, të ringjallur, përfundimisht fitues mbi vdekjen: prej andej lindë siguria e tij, gëzimi i tij, mënyra e tij e të jetuarit të asaj rrethane si dhe gjdo moment të ekzistencës së tij («qofte nëse unë jetoj apo vdes»). Gjithçka ishte përcaktuara nga raporti me atë prani. Tani – unë them duke menduar për ate që po ndodhë këto ditë, që përfshinë edhe shumë të krishterë –, Krishti nuk anulon dramën dhe dhimbjen për ndarjen nga më të afërmit, por e bënë të mundur një mënyrë tjetër të jetuarit dhe të qëndrimit para vdekjes, ne të cilën nuk dominon asgjëja, por siguria e pranisë së Tij fitimtare, të nje përqafimi pa kufij, dhe prandaj te përmbushjes se jetës, të raportit përfundimtarë me Të. Mund të jetë kështu vetëm për atë që ka parë të shfaqën në përvojën e tij shenja të asaj përmbushjeje dhe të rrit një dëshirë mbi të gjitha të tjerat, atë – shkruan shën Pali – «të jesh me Krishtin, do të ishte shumë më mirë ».³³ Jo si një përbuzje ndaj jetës, po pikërisht nga dashuria për jetën që kërkonë amshimin.

³³ Fil 1,21.23.

Po si mundet njeriu sot, duke parë atë që po ndodhë, i zhytur në mentalitetin që thithim, të njohë të vërtetën e këtyre pohimeve?

Pohimet e tilla bëhen të besueshëme vetëm nëse shohim këtu dhe tani njerëz në të cilët dokumentohet fitorja e Zotit mbi frikën dhe vdekjen, prania e Tij reale është bashkohorë, dhe prandaj një mënyrë e re për të përballur rrethanat, të mbushur me një shpresë dhe lumturi që normalisht janë të panjohura dhe së bashku duke kërkuar nje veprim te pafytyr.

Më shumë se çfar do diskutimi ose moralizëm, ajo për çka kemi nevojë është pikrisht të shohim njerëz ne të cilët mund të shohim të mishëruar përvojën e kësaj fitoreje, të një përqfimi që lejon të qëndrojmë përballë plagës dhe vajtjes, të dhimbjes, ne të cilin është e dëshmuar ekzistenca e një kuptimi në përpjesëtim me sfidat e të jetuarit.

A ka njerëz të tillë?

Ka, posi jo! Në momente si këto tani është imediate ti shohim, për mënyrën ndryshe se si jetojnë, shpresa që bartin. Bashke me ta, aty ku i gjejmë, do të jete më lehet të rifillohet, të

ngrihemi nga rrëzimet, duke rindërtuar pjesë për pjesë një strukturë shoqërore ku mbyllja dhe frika nuk janë fjala e fundit.

Të tillë i shoh shumë edhe në mesë të mjekëve, infermiereve dhe infermierëve. Janë prani me të vërtet «miq», që na dëshmojnë një rrugë të mundshme; janë prani që nuk i programojmë ne, kaq esenciale – edhe pse brenda rrethanave si gjithë të tjerët – që na lënë pa fjal, në qetësi. Si personi që e ka shkruar letrën të cilën tani do të citojë. E kam menduar nëse duhet ta them këtu, sepse me referohet mu, por më është dukur se megjithatë ja vlen.

«Papritmas jam katapultuar në llogor. Më duket sikur jam në luftë. Përditshmëria ime në punë dhe familje brenda një dite ka ndërruar. Si mjeke, si nënë, si grua gjindem e izoluar nga bashkëshorti im, duke mos i parë fëmijët e mijë tash e dy javë, duke mos pasur kontakt me pacientet e mij. Në mes meje dhe të sëmurëve të mijë është një maskë, dhe një skafandër. Shpesh janë të moshuar që e jetojnë të vetëm këtë moment. Kane frikë. Ata vdesin vetëm. E familjarët e tyre, të izoluar në shtëpi, nuk mund ti ndihmojnë të afërmit të tyre, dhe marrin telefonata natën me të cilat ju komunikohet vdekja e familjarit të tyre: në mesë meje dhe atyre është telefoni. Çfarë

mund të bëjë unë për ta, si e krishterë? Hy në repart, krkojë një buzëqeshje dhe perqafimin e një infermiere mike: në këtë moment të ziolimit kam nevojë që të ndjejë edhe afërsi fizike. Dhe mund të përqafoj vetëm ata. E në gjithë këtë me mbeshtet të lexuarit gjdo dite të letëresë së Carron në *Corriere della Sera*,³⁴ që më ndihmon të kem një qendrim të hapur, dhe të pyes se çka në fakt qëndronë (reziston). Jam e thirrur që të njohë thelbësoren, të vërtetën. Pastaj në tekst është i gjithë përsëkrimi për Shkollën e Koumintetit [katekizmi i vazhdueshëm në lëvizjen Bashkim dhe Lirim; *ndr*]: dëshmia është mënyra se si feja mund të rritet nëse liria rrezikohet, përball preferenës që na kërkon gjithçka.

Dhe kjo është e frikshme. Ne duhet ti besojmë dhe të rrezikojmë. Qartësia që e mbështet jetën tonë është një lidhje, është një rrugë që duhet të bëjmë për të arritur të kjo qartësi. Rrethanat që na janë dhënë për të na lidhur edhe më shumë me Te, është duke na thirrur në një mënyre misterioze. Feja është të besojmë se ai po na thërret. “Vetëm kur dominon një përvojë e bazuar jemi në gjendje të përballojmë rrethanat pa ikur”. Jemi të thirrur

³⁴ «Ja se si ne veshtiresi mesohm te mposhtim friken », *Corriere della Sera*, 1° mars 2020, p. 32.

sot më shumë se kurr që t'i përgjigjemi Ati që na thërret në mënyrë të mistershme. Dhe është kjo qartësi që mund t'ju a jap të sëmureve të mijë, familjarëve, përtej ndihemës mjekësore».

Janë prani që komunikojnë një qartësi, një shpresë të bazuar, për këdo që takojnë në rrugën e tyre dhe mund ta komunikojn atë vetëm sepse e jetojnë.

Me pak fjalë, një ligjërimit "i krishterë" nuk është i mjaftueshëm"...

Vetëm dëshmia, është e nevojshme, dokumentimi i një diversiteti njerzorë i gjeneruar nga takimi i krishterë i jetuar me vetëdije. Dhe nuk mund të "shpikim" dëshmi, mundemi vetëm të komunikojm, ofrojm të tjerëve përvojën tonë si një ecje personale. Kohët e fundit kam folur me një grua që burrin e ka pozitivë me Coronavirus. Nuk mund të shkoj ta takoj, nuk mund të qëndrojë me të as edhe një minut të vetëm. Dhe ka një vajzë të vogël. Një ditë më tha: «Shiko? Në këtë moment do të doja ti oforjë ndihmen time, afërsin time, ndërsa unë jam keëtu, e bllokuar, me vajzen time». U mundova ti them: «Edhe ti duhet të pranosh ti përgjigjesh rrethanava që ke,

ashtu siç është duke u munduar të bëjë burri yt përballë realitetit që ka përpara. Përndryshe, nëse ti nuk e bënë një rrugëtim, nëse ti nuk e jetone një raport me një Prani që e mposhtë frikën, kur do ta thërrasësh me *FaceTime* për të parë ty dhe vajzën, çfarë ndihme do ti japësh (si do ta ndihmosh)? Ti mund ta ndihmosh në vështirsinë e tij, mund ti ofrosh një kontribut deri sa është duke vuajtur në spital me Coronavirusin, vetëm nëse e bënë ecjen tënde: edhe nëse nuk do ti thuash as një fjale, në fytyrën tënde do të mund të shohësh shpresën që mund ta mbështesë».

Çfarë ngjallin tek ti njerëzit, që siç thuhet, gjinden në vijën e parë të frontit kundër Coronavirusit, të cilët janë të ekspozuar ndajë rrezikut vazhdimisht?

Kam parë këto dite një shpërthim të bujarisë, një dedikimi dhe një kujdesë që thellësisht më ka prekur. Ajo që ndjej është një mirënjohje e pafund për ata që bashkëndajnë, duke vu në rrezik veten e tyre, për nevojat e vëllezërve të tyre.

«Kur shohim të tjerë që janë më keq se ne, ndjehemi të shtyrë që ti ndihmojmë me sado pak që mundemi. Një nevojë e tillë është aq

originale dhe e natyrshme, sepse është në neve akoma përpara se sa ne jemi të vetëdijs-hëm dhe me të drejtë ne e quajmë ligji i ekzistencës. [...] Të interesohemi për të tjerët, të komunikojmë me të tjerët, na bënë të përmbushim supremen, madje kështu në realizojm, të vetmën detyrë të jetës, që është realizimi i vetës tonë, përbushja e vetës tonë ». ³⁵ Takimi i krishterë ka për qëllim të mbështesë dhe të bëjë gjithnjë e me stabil dhe të vërtet këtë vrull njerëzor, të lartësoj njerëzoren brenda njeriut, në mënyrë që jeta të bëhet në secilën shprehje të asaj “bamirësi”, dhurim falas i vetës.

Kjo periudhe e vetmisë së detyruar, kjo “rrethan”, nuk është një pengesë për përvojën e krishterë për të cilën ke folur? “distanca sociale” imponon një distancim edhe nga ato “prani” të cilat i përmende pak më herët, një ngadalësim të bashkëndarjes, shoqërisë...

Në të kundërt, mund të jetë një rast i madhë për thellimin e përvojës së krishterë, për pjekurin e fes, do të thot për zbulimin e përmbajtjes së takmit të bërë, për origjinen

³⁵ L. Giussani, *Kuptimi i bamirësisë* ne Publikime, clonline.org, pp. 5-6.

e asaj miqësie që kemi filluar ta ndjejmë si një vend ku gjerohehi. Nëse nuk ndodh ky zbulim, mbesim në siperfaqe, rrezikojmë të reduktojmë në mënyrë sociologjike ngjarjen e krishterë, për të zhvlersuar miqësinë nga kuptimi i saj. Po mundohem ta sqaroj më mirë me një shembull. Një mik i imi i ri është diplomuar dhe ka filluar një jetë të re. Si pasoj, nuk arrim të takohemi si më parë në kohën e studimeve. Kohët e fundit ai ankohej për këtë. Dhe për këtë ja kam kujtuar një pasazh nga Ungjilli. Një ditë dishepujt ishin në bark me Jezusin dhe ju bie në mend se kane harruar të marrin bukë me vete. Edhe pse dy here kishin qenë dëshmitar të dy mrekullive të mëdha sa një kështjell – dy shumfishime të bukës sikur asnjëherë në historinë e njerzimit, filluan të zihen në mesë vete sepse kishin harruar të merrnin bukën. Ajo që po bëja isht se po i kujtoja mikut tim se Jezusi ishte aty, afër tyre, në bark! Dhe ata vazhdonin të ankohehin! Problemi nuk ishte se ata ishin vetëm, sepse Jezusi ishe me ta, por për ta ishte sikur ai te mos ishte me ta. Dhe në fakt diskutonin në mes vete se nuk kishin bukë! Per te treguar se ku ishte problemi, Jezusi nuk bënë një tjetër mrekulli. E çfarë do të shërbente të bënte një tjetër, pas gjithë atyre që tanimë ata kishin parë? Çfarë kontributi jep athëre Je-

zusi? Ju shtron atyre pyetje. E para: «Sa bukë kanë tepruar pas shumfishimit të parë?». Dhe pastaj: «Sa kane tepruar pas shumëfishimit të dytë?». Dhe në fund: «Akoma nuk e keni kuptuar?». ³⁶ Sa i çmuar është kontributi që Jezui u ofron miqve të tij duke mos i kursyer nga ato pyetje! Nuk shton shpjegime, nuk bënë mrekulli të tjera, por i nxit, nga brendësia e përvojës së tyre, që të përdorin deri në fund arsyen, ne mënyrë që ta kuptojnë se kënd e kanë takuar (me vete e kishin zotërin e “fur-rës”!). kujdes, nëse ata nuk e kishin kuptuar, nuk ishte se ata ishin vetëm dhe që nuk kishin elemente te mjaftueshme, por sepse akoma nuk e përdornin mirë arsyen. Jezusi në fakt i ishte shfaqur atyre në për mjet shumë shenjave që kishin parë, me një pergjigje të jashtzakonshme, më në fund që i pergjigjet zemrës, atyre dhe të tjerëve, në shumë raste, edhe dramatike, por ata nuk e kishin njohur akoma kush ishte, me atë njohjen që quhet fe « lulëzon në kufirin e skajshëm të dinamikës racionale si një lule Hiri, në të cilën njeriu aderon me lirin e tij». ³⁷

Feja e krishter nuk është njohja e “hynores”,

³⁶ Cfr. Mc 8,19-21.

³⁷ L. Giussani, S. Alberto, J. Prades, *Gjenerimi i gjurmeve ne historine botes*, op. cit., pp. 45-46.

por të “hynores të pranishme” në njërzoren, në Jezusin e Nazaretit, në Krishtin, dhe sot në atë shenje të Krishtit që është miqësia e besimtarëve në Te. «Ngjarja e Krishtit mbetet në histori përmes miqësisë së besimtarëve»,³⁸ «Jezu Kirshti, ky njeri i para dy mije vjetve, i fshehur, bëhet i pranishëm, nën një tend, nën dukjen e një njërzimi tjetër. Takimi, impakti, është me një njërzore ndryshe»,³⁹ me një fenomen të një njerzoreje ndryshe: njeriu e takon dhe befasohet me një ndjenjë të re për, dicka që e rrit mundeën e tij për të pasur qartësi, pozitivitet, shpresë dhe arsye për të jetaur. Shumë prej neve mund të na ketë ndodhur ky “impakt”, pa u pjekur ajo njohje që quhet fe, që lulëzon si një tgaranci mbi kufirin ekstrem të dinamikës racionale, duke implikuar kështu të gjithë rrugëtimin e arsyes, të dhashurisë, dhe të lirisë së njeriut. Kjo rrethan e izolimit të deyruar, pikrisht për aq sa na nxit që të mos marrim për të qenë realitetin njerzorë në të cilin gjindemi, mund të jetë një rast i madhe për të bërë në mënyrë më të vetëdëshme e personale këtë rrugëtim, për të vërejtur natyrën e ngjarjes që e kemi

³⁸ *Ibidem*, p. 55.

³⁹ L. Giussani, «Diçka që vjen me pare », *Tracce-Litteraecomunionis*, n. 10/2008, pp. 1-2.

përpara në formën e një takimi njërzorë magjepsës dhe bindës. Mund ta kapim këtë rast ose ta lëshojmë vetën në ankesa, si dishepujt në bark.

Qëndron gjithësesi, në këtë situat të izolimit të detyruar, fakti që nuk mund bashkëndajm dhimbjen, vujatjen, e të afërmve tanë, që duhet të braktisin ata në një spital ...

Është pyetja që ma ka shtruar një vajzë nga Madridi gjatë takimit me disa student me të cilët jam lidhur në një video konferencë në javën e fundit të marsit. Ajo thoshte: «ne këto ditë gjyshi im është në spital, me siguri do të vdes dhe në familje e kemi një pyetje të madhe, pse nuk mund të jemi bashkë me të; jo vetëm që është duke vdekur, por është duke vdekur vetëm. Unë e ndjej të gjithë pafuqinë time dhe i them vetes time: “Pse nuk mund të jem me të? Pse nuk mund të jem tash me të?”». Këtu është evidente se rrethant në një farë mënyre imponojnë një sakrificë: ajo çfarë do të donim të benim nuk mund ta bejmë, e kemi të ndaluar. Por çështja është nëse rrethant ashtu si janë “na janë dhënë”, do të thotë edhe pse e pashmangshme – nuk mund ti largojmë, ndryshojmë, modifikojmë, përn-

dryshe, sidomos ne raste si ky, do ta bënim menjëherë dhe në mënyrë të ndjeshme –, është varr, zbrasi absolute, asgjësimi i pastër, ose është thirrje, vendi i një thirrje misterioze, mënyra me të cilën Misteri, që gjithë realiteti nënvizon, me provokon mua ne përmbushjen e jetës, ne rrugëtimin drejt jetës. Kjo është alternativa.

Nëse e njeh realitetin si nje thirje, ajo vajzë mund të thotë, siç ne fakt ka thënë, duke vazhduar intervenimin e saj: «Edhe kjo rrethan është për mua. Edhe kjo pafuqi është për mua. Edhe vetemija e gjyshit tim është për të. Mua më kërkohet gatishmëria që të aderoj ne ato shenja të Misterit që janë rrethanat, që të ndjek provokimin e realitetit». Është e frikshme, thash më herët, dhe është dramatike. Misteri është njeri sepse që njeriu të mund të mbajë këtë frike të kalloj dhe përqafojë këtë dramë. Ajo vajze e ka dokumentuar para të gjithë atyre që e dëgjonin. «Po-ja» për rrethanat bëhet «po» për Misterin e bërë njeri, ati njeriu, Jezu Krishti, i vdekur dhe i ringjallur, i pranishëm këtu tani – pas dymijë vjetësh – në njerzorën e një miqësie njerëzore të gjeneruar nga Ai, i dallueshëm për disa tipare të pa gabueshme njerëzore. «E verteta e fese», thoshte Giussani ne vitin 1972, ne një moment historik të

ngarkuar me veshtirësi, «shihet, nga aftësia për ti bërë instrumente te pjekurisë» ajo që «na duket si kundërshtim, persekutim, ose megjithatë si vështirësi».⁴⁰

Pra, kush është i kufizuar në muret e shtëpisë është i thirrur të bëjë të njejtën përvojë me ata që janë në vijën e parë të frontit?

Zemra e përvoje nuk ndërron. Çështja është ti përgjigjemi realiteti që na thërret, thellësisë së tij misterioze, të realizojmë pikrishtë në për mjet rrethanave që na janë dhënë një hapë përpara fatit tonë, përmbushjes tonë, duke zbuluar çfarë, dhe kush na ndihmon të ja dalim në këtë tension. Jam duke menduar tani për një student të ri, që deri para disa javësh ishte në qendër të një vorbulli marrëdhëniesh, gjithmonë jashtë shtëpisë, i përfshirë në mijëra takime dhe iniciativa. Papritmas vendimi i qeverisë e detyron, si gjithë të tjerët, që “të izolohej” në shtëpinë e tij. Për shumë dite, 24 orë në ditë, në kontakt me prindërit e tij. Në vend që këtë situatë ta perceptoj si një fatkeqësi, e merr si një mundësi, një provokim,

⁴⁰ L. Giussani, «La lunga marcia della maturità», *Tracce-Litteraeommunionis*, n. 3/2008, p. 57.

në kuptim siç e tham më herët. Dhe pas dy javësh më shkruan:

«Përpara perspektivës se duhet të rrim ne shtepi me kishte kapur frika, sepse unë gjithmonë jam munduar të ik nga shtëpia, asnjë herë nuk jam ndier rehat aty. Por pastaj mu kujtua shikimi falënderues që kam marrur në këto vite, në takimin me disa perosna të komunitetit, dhe momente ne të cilët ne këtë periudhë kam arritur të qëndroj përball prindërve të mij pa “i matur”. Dhe e kam kuptuar se ka ndodhur kur në ditën që e kam njohur Krishtin të pranishëm: vetëm ne ato momente kam qenë i lirë përball tyre. E kam filluar këtë izolim duke u lutur si asnjë herë më parë. Thoja: “Të lutem Zot, bëhu i pranishëm”. Ajo çfarë po më befason është se kam filluar të shoh se problemi nuk ka qene asnjë herë komplet te ata, përkundrazi mbi të gjitha problemi ishte te unë, sepse i shikoja sipas një imazhi përfekt, i krahasoja me të tjerët dhe i skualifikoja. Në këto dite kam filluar ti “shoh” e kam kuptuar kush jane. Deri tani mendoja si di gjithcka per ta dhe madje as nuk provoja të hyjë ne bised me ta, të kaloj kohë me ta. Ndërsa, këto ditë ata janë miqët e mij të jetës dhe janë duke ndodhur gjera qe nuk i kisha imagjinuar».

Ky djal nuk ka mundur të vazhdoj ti trajtoj

prindërit sipas imazhit të familjes që kishte, bashkëjetesa e ngushtë – e pranuar, e jetuar si thirrje – e ka shtyrë të bëjë llogarit me ta se si janë ata ne të vërtet, dhe kjo ka qenë një përfitim për jetën e tij, i ka parë menjëherë efektet. I ka thënë po sfidës së realitetit dhe kështu ka bërë hapa të papritur.

Duke aderuar në rrethana, duke ju shkuar deri në fund disa situatave – ne të cilat jemi të “detyruar” për shkak të situatës –, mund të bëjmë zbulime që shejojnë një pike të paktim në jetën tonë. E ka dëshmuar së fundi një studente e re, e cila në një tjetër takim në video konferencë, tregonte:

«Para disa javësh, pas një viti e sëmur, vdiç nëna ime. Saktësisht një javë pas varrimit, me është dashur të mbyllem në shtëpi vetëm. Vëllezërit e mijë jetojnë në përndim e babi del nga shtëpia në ora 6,30 të mëngjesit për të shkuar në punë në spital dhe kthehet në ora 8,30 të mërkurës. Në këto ditë të vëtmisë, të cilat nuk e mohojë janë sfiduese, po e kuptoj se si kjo situatë dhe këto kushte mund të privilegohen. Për të mos humbur kotë gjithë ditën, jam e detyruar të pyes vetën sapo ti hap sytë, për çfarë kam me të vërtetë nevojë. Disa miqëve ju kam kërkuar të më qëndrojnë afër të më ndihmojnë të zbuloj se çfarë po jetoj. Veç kësaj kjo situatë nuk më lejon të hutohem nga

vdekja e nënës sime, përkundrazi, edhe nëse merrem vazhdimisht me punët e shtëpisë nuk mund të mos i kujtoj gjestet e saj, fjalët e saj, 24 orë në 24. Megjithatë, në dhimbjen që e ndjej se ritet gjod dite e më tepër, e kuptoj që nëna ime, edhe pse në një mënyrë ndrysh nga më parë, është e pranishme në jetën time, më bënë të lëvizë gjatë ditës në dukje krejtësisht të njëjta. Funksionon saktësisht si me të fejuarin tim, që nuk është fizikisht me mua, por është, e jeton karantinën e vet në kilometra distancë, dhe vetëm fakti që ai është atje dhe më shkon mendja të ai gjatë ditës, më bënë të lëviz. Jeta që është gjeneruar në mua pas vdekjes së nënës sime – jam duke e kaluar këtë vetmi duke bërë thjesht atë që duhet të bëjë, por me një qetësi brenda që nuk arri ta shpjegoj – më bënë të them, edhe pse këmbët me dridhen, që Krishti me të vërtetë bënë që jeta të fitoj mbi vdekjen. Në këto dite në mua është një mirënjohje për gjithçka që ka noddhurë. Me hapa të njëjt rritet në mua edhe një dhimbje, sepse babi im në mbrëmje kthehet nga spitali i tronditur, me një nostalgji të pafund për nënën, dhe darkat tona kalojnë gjithmonë në heshtje. Pafuqia ime më trishton, dhe pyes se çfarë po kërkohet nga unë në këtë rrethanë, çfarë do të thotë realisht “të ofrosh” për të pastruar rrobat ose për të studiuar një faqe libër».

Çfar kontibuti mund ti jap kjo vajze të atit, kur ai ktheht në mbrëmje i rraskapitur dhe nuk ka dëshirë të flas? Pikrisht rrugëtimi që është duke bërë, vetëdija për veten dhe për atë që e bënë të jetojë që është duke lindur në të, fytyra e saj mirënjohëse.

Së fundi, në një Letër drejtuar miqëve të Lëvizjes Bashkim dhe Lirim, pikrisht në lidhje me situatën me Coronavirusin, është shkruar: «Njohja e Krishtit, është “po-ja” për Te, edhe në izolimin në të cilin secili prej neve mund të jetë i detyruar të qëndroj, tashmë është kontributi për shpëtimin e secilit njeri sot, përpara gjdo tentative legjitime për të qëndruar afër, i cili gjithashtu duhet të ndiqet brenda kufijve të lejuar».

Doja të thoja se kontributi ynë më i madhë në këtë botë është «po-ja» jonë në thirrjen e Misterit, «po-ja» Krishtit, fesë, dhe mbi të gjitha jo ajo që ne arrim të bëjmë. Në fakt, edhe kur bëjmë – si ata që sot janë në vijën e parë të frontit –, kontributi jone më i madhe mbetet «po-ja», sepse kjo – sa më në mënyrë autentike të jetohet – ndryshon vet mënyrën e të berit të asaj që duhet të bëjmë, e bënë akoma më të dobishme për vellezerit tonë njerëz. Le të jetë e qartë, nuk ka asnje kontradit në mesë fes dhe vepri-

meve, përkundrazi: feja është ajo që e themeloi veprimin në plotin, është rrënja e ati veprimi që ndërmerr – me anë të Hirit – forma e bamirësisë, të një pohimi pa kushte për të mirën e tjetrit, që do të pasqyrohet sipas rasteve të ndryshme. Kontributi me origjinal që mund japim botës është njohja jonë e Krishtit, «po-ja» jonë Ati, si ata që janë në punë e edhe ata që e kanë të pamundur të punojnë. Në krezhmet e vitit 2006, Benedikti XVI e ka shprehur në një formë që ne të gjithë e mbajm mend:

Edhe sot, në kohën e ndërvarësisë globale, mund të konstatojmë se asnjë projekt ekonomik, social ose politik mund të zëvendesojë dhurimin e vetës për tjetrin në të cilin shprehet bamirësia. Kush vepron sipas kesaj logjike ungjillore e jetonë fen si miqësi me Zotin e mishëruar, dhe si Ai, merr përsipër nevojat materiale dhe shpirtërore të afërmit të vet. E shikon si një mister i pamatshëm, i denjt për kujdes dhe vëmendje të pafund. E din që kush nuk i jep Zotit jep shumë pak, siç thoshte e lumja Nënë Tëreza e Kalkutës: “Varfëria e parë e popujve është mos njohja e Krishtit”. Prandaj është e nevojshme të gjejnë Zotin në fytyrën e Krishtit: pa këtë perspektive, nuk mund të ndertohet një civilizim në baza solide». ⁴¹

⁴¹ Benedikti i XVI, *Mesazhi për Krezhmet 2006*.

Situata te cilin shumë janë duke e jetuar, në izolim dhe bllokim të detyruar, mund të jete një rast për të parë se feja e jetuar është kontributi origjinal që, si i krishterë, mund t'i japim të tjerëve,: sepse, nëse në tentativën tonë për ti qëndruar afër tjetrit – brenda kufijve që na janë imponuar sot – nëse nuk shpeërfaqë Krishtin, «po-ja» jone, do ti japim tjetrit «shume pak», nuk do ti japim thelbësoren. Prandaj, edhe ne izolimin në të cilin secili prej neve është i detyruar të qëndroj, «po-ja» jone Krishtit është kontributi për shpëtimin e secilit prej nesh, para gjdo tentative legjitime për të qëndruarë afër tjetrit.

Kjo shkatrrën imazhin që ne kemi për kontributin tonë në botë, për të mirën e njerëzve, duke filluar nga ata më të dashur. Është arsyeje pse shume ndjehën të padobishem. Shkurt, pamundësia për të “bërë” na dekurajonë...

Mendoj gjithmonë për faktin se Shën Teresina e Krishtit Fmije, një murgeshë e klauzres që kishte vdekur shume e re, është proklamuar nga Kisha mbrojtëse e misionit. Si është e mundur? Çfarë thotë Kisha për të? Qe «po-ja» e saj – e fshehur, në zell sipas mentalitetit të botës – ka përkuar me të mirën e botës. E

kuptoj se kjo e prish imazhin qe zakonisht ne kemi per kontributin qe duhet te japim per te tjeret. Si eshte e mundur qe nje vajze qe nuk ka dalur kurr nga kuvendi mund te quhet nga Kisha si misionaria me e madhe, mbrojtese e misionit? Duket absurde. E ne fakt «po-ja» e asaj murgeshe te vogel ka pasur nje kuptim te fuqishem per boten. Le te mendojm vetem se sa njerz kanë ndryshuar nga feja e saj, nga deshmia e jetes se saj, drejt per se drejti ose indirekt. Siç e perseriste shpesh, «po-ja» e Zojes se Bekuar, e thene ne errësirën enigmatike, ka qene kontributi me i madhe ne jeten e botes dhe te secilit njeri, siç eshte per ne «po-ja» e don Giussanit dhe shume te tjerëve.

Kam lexuar keto dite librin e *Van Thua, I lire midis hekurave*, te Teresa Gutiérrez de Cabiedes,⁴² qe tregon historine e nje deshmitari te madhe te fesë, nje jetë e kaluar ne besnikëri te qendrueshme dhe heroike ne thirrjen e vet, siç ka thene per te papa Gjon Pali i II. Ne vitin 1975 François Xavier Nguyen van Thuan, me nje here pas nimit te tij arqipeshkv ndihmes (Ho Chi Minh Ville, Vietnam), akuzohet si trathetar dhe arrestohet: «Nguyen Van Thuan[...] te

⁴² T. Gutiérrez de Cabiedes, *Van Thuan. Libero tra le sbarre*, Citta Nuova, Roma 2018.

kemi sjell këtu sepse je fajtor, i ke shka-ktuar probleme Qeverise se popullit so-vranë të Vietnamit. Akuzohet për propa-gnd imperialiste dhe qe është i infiltruar nga forcat e huaja ». I kaloj 13 vjet ne burg prej tyre 9 ne izolim. Jam impresionuar se si ai e ka jetuar ate rrethane. I mbyllur ne nje burg te tmerrshëm, ai pyet se cfarë dobie ka jeta e tij: «Për cfar me shërben jeta nëse nuk arri të përmbush misionin për të cilin kam lindur?». Prandaj, «i përkulur në toke, i kthehet Zotit duke ju lutur qe ta lirojn. [...] “I kam lënë vetëm jetimet e mijë, të varferit e mij, familjen time. [...] Dhe tani? Cfar kuptimi ka te revoltohem këtu si nje insekt?”». Gjithcka i dukej e kote, pro Mi-steri kishte nje surpëriz për të. Në dialogun e tij të brendshëm me Zotin, ndjen një zë që i thotë: «Ajo cfarë ke bërë është e madhe. [...] Ankohesh se nuk po punon për mua. Pse nuk i lë anash projektet e tua? Me do mua apo veprat që bënë për mua? [...] Sh-qetësohesh për njerzit e tu sepse i do. Unë do të ju ndihmojë! Ki besim në mua. Do të kujdesem për veprat e tua jasht».⁴³

Rezultatin e «po-së» së tij ai e ka parë me kalimin e kohës, sepse ne fillim sigu-

⁴³ *Ibidem*, pp. 9-10, 67-69.

risht se nuk mund te imagjinonte çfar do të lindte nga dorëzimi i tij. Vetëm kur ka pranuar që të bëjë rrugëtimin misterioz që ishte projektuar para tij, ka parë me befasi se të gjithë ata që i takonte në burg ndryshonin. Mbi të gjitha rojet që e mbikqyrnin. Kjo është aq e vërtet sa që zyrtaret i ndronin rojet vazhdimisht, sepse nuk arrinin të evitonin «kontaminimin», nuk arrinin të evitonin ndryshimin e personave që hynin në kontakt me Van Thuan. «Te gjithë duan te ndajnë qelin me ty», i bërtisnin ata që e mbanin të borgosur, «por nuk do të lejoj që te kontaminosh te gjithë të burgosurit e mijë».⁴⁴ Nga një here ky lulëzim është i dukshëm para syve tanë, e nganjëherë jo, por kjo nuk do të thotë që ajo «po» për Misterin nuk do të prodhojë efekte në të ardhmen.

Ajo që me ka goditur me se shumti është momenti në të cilin Van Thuan pyet pse Misteri lejon që ai të kalojë në atë rrethanë. Ishte e njëjta pyetje që i bënin rojet, që nuk arrinin ta kuptonin pse vrazhdonte me sjelljen e tij kur, duke u penduar se “kishte trathtuar”, do të lirohej dhe do të mund të kishte një të ardhme të ndritur. Sa më shumë jemi të sfiduar nga rrethanat aq më te-

⁴⁴ *Ibidem*, p. 187.

për pyetja del ne shpërfaqe. Megjithatë, një pyetje tjetër në këtë drejtim, e drejtuar nga ata që e donin ne burg, ai u pergjigjet se ka pasur kohë të mjaftueshme për të reflektuar nëse ishte një gabim që të vrazhdonte me sjelljet e tij, që do të thotë ti besonte planit të Dikujt tjetër, dhe shton se sa me shume e mendon aq me shume ndjehet i lumtur që ka pranuar, që ka parë të lulëzoj ne vetvete një liri brenda burgut.

Rezultati, kontributi për të mirën e botes është gjenerimi i një njeriu të lire, me një liri që nuk mposhtet nga asnjë lloj burgimi. Është një gjë që do të përmbushet vetëm në amshim, por mund të shihet edhe në të tashmen: lulëzon një liri e pa imagjinueshme, që është një dëshmi para të gjithëve: «E si ja bene? Ta kam bërë jetën të pa mundur ...», e pyet. E Van Thuan: «Si mos të bërtas nga gezimi kur shoh se Dikush me jep këte dashuri që shkatërron urrejtjen dhe fyerjen?».⁴⁵ Edhe ati i duket e pa mundur që dikush e bene të lulëzoj kështu, e bene të lire kështu, që lulëzimi të vije sipas një plani dhe në një kohë që nuk janë tonat; dhe nëse dikush e pranon, rezultatin shkonë përtje çfardo pritshmërie.

Kush e di se si ne, të detyruar të rrim në

⁴⁵ *Ibidem*, p. 322

shtëpi për të evituar kontaminimin, jemi duke bërë llogarit me rrethanat në të cilat jetojmë! Po mbyetmi, sikur nuk do të kishim rruge dalje, apo jemi duke e zbuluar veten më të lirë?

Nga e gjithë ajo që jemi duke jetuar, çfarë do të mbetet kur emergjenca do të kaloj?

Dikush ka shkruar se nga pandemia e madhe do të dalim të ndryshuar. Unë po shtoj: do të dalim të ndryshuar, por vetëm nëse fillojmë të ndrrojmë qe tani. Qe do te thotë nëse e kuptojmë se çfarë po na ndodh, nëse jemi te pranisem ne te tashmën dhe mësojm tani që të gjykojmë çfar jemi duke jetuar, të mbyllur në shtëpit tona apo të angazhuar në vijën e parë për të bërballuar kontaminimin. Ndryshimi nuk vjen si rezultat i akumulimit të goditjeve, të ngjarjeve dhe të përshtypjeve të gjërave që na ndodhin, por si rezultati i të kuptuarit të thelbit të asaj qe na ndodhë, do të thotë vetëdijsim. Prandaj ndryshimi nuk mund te jete mekanik. Nga kjo situat do të dalim të ndryshuar nëse do ta thellojmë tani, për mes provokimeve që realiteti na drejton, të zbuluarit se kush jemi dhe pse ja vlen të jetojmë, dhe çfarë na ruan nga shkatrimi. E citoj shpesh një fraz të Benediktit të XVI:

«Këtu një përparim shtesë është i mundur vetëm në fushën materiale. Në vetëdijen që rritet të strukturës së materies dhe në korrispondenc me shpikje gjithmonë më të avancuara, kemi natyrisht një vazhdimësi të progresit drejt një zotërimi gjithnjë e më të madhë të natyrës. Ndërsa në fushën e vetëdijes etike dhe të vendimeve morale nuk ka një mundësi të ngjajshme të shtimit për aryesn e thjesht se lira e njeriut është gjithnjë e re dhe duhet gjithmonë rishtazi të marr vendimet e veta. Asnjë herë vendimet nuk mirren nga të tjerët për neve – në një rast të tillë, në fakt, nuk do të ishim më të lirë. Liria presupozon që vendimet thelbësore të secilit njeri, të secilës gjenerat të jenq një fillim i ri».⁴⁶

Kjo do të thotë, se nëse nuk fitojmë shprehi që te gjykojmë atë që po na ndodhë ne këto dite të izolimit të detyruarë ose të angazhimit për të luftuar virusin, do të humbim gjithcka. E nënvizon Paolo Giordano: «Ka një muaj që i paparaftyrueshmi ka shperthyer ne jetët tona. [...] Por ne një moment do të përfundojë. [...] Deri sa ne, të shpërqëndrua, do të kemi vetëm dëshirë të shkundim nga vetja gjithçka. Terri i madhë që bie. Fillimi i harresës. Përveq nëse nuk guxojmë të reflektojm tani. [...] Të

⁴⁶ Benedetto XVI, *Spe salvi*, 24.

imagjinojmë cka më pas, duke filluar që tani. Të evitojm që i paparaftyrueshmi të na kap, në befasi, edhe një herë tjetër».⁴⁷

Është fjala për një verifikim që duhet të bëjmë gjdo ditë në rrugtimin tonë, që nga mengjesi e deri sa shkojmë për të fjetur në mbrëmje. Giordano shkruan: «Kam vendosur të mbush këtë boshllëk duke shkruar [...]: nuk dua të humb atë që epidemia është duke na zbuluar nga vetja jonë. Sapo të kapërcejmë frikën, gjdo vetëdije e paqëdrueshme do të zhduket në një çast», por «por disa reflektime që virusi është duke ngjallur tani do të jene akoma të vlefshme».⁴⁸Dhe sigurisht, pa punuar mbi vetën tonë, gjithçka do të zhduket dhe do të kthehemi në gjërat e zakonshme pa mësuar asgjë nga kjo rrethanë e quditshme dhe e dhimbshme. Por këtë punë vetëm ne mund të vendosim ta bëjmë: është e vetmja gjë për të cilën asnjë dekret ose rregullore nuk mund të na detyrojë. Në këtë nivel nuk ka asgjë mekanike. Prandaj, le të vendosim! Është një punë që kërkon vëmendje, në të cilën arsyeja dhe liria, duhet të jenë gjithmonë të

⁴⁷ *Corriere della Sera*, 21 marzo 2020.

⁴⁸ *Corriere delle Sera*, 24 mars 2020.

dhëna, të gatshme që të kapin momentin që kalon. Përndryshe, sakrifica dhe vështirësit do ti lën vendin harresës. Për këtë është shumë mirë i vetëdëshëm Eugenio Borgna, si njohës e shpirtit njerzorë: « Lehtësisht, kur rreziku largohet, njerëzit fillojnë të harrojnë. Por do të jene disa, nuk e di se sa, që në këtë kohë të dhimbjes do të kapin rastin për të qenë më të vemendshëm, për të dëgjuar vetën dhe të tjerët me thellësisht. Po, disa nga ne, pas kësaj sprove të thart, do të rilindin: të aftë për një shprehe të re». ⁴⁹

Ndërkohë, sidoqoftë, pandemia vazhdon. Në këtë pikë, është e qartë për të gjithë se ky nuk është një fenomen që kalon.

Këtu shfaqet çmueshmëria e kohës, dhe kjo teston pozicionin tonë para gjërave, menyrën se si ne e perballojmë jetën, raportet, situatat. Kur realiteti nuk përkulet nga pritjet tona, strategjit, iniciativat, vie ne shprehje konsistenca jone dhe bagazhi i bindjeve tona, qofshin ato laike ose religjioze.

⁴⁹ *Avvenire*, 25 mar 2020.

Qe nga fillimi ne kemi parë shumë luhatje në marrjen në konsiderat dhe përballjen me epidemin. Pse është kaq e vështirë të marrësh rrugën e duhur?

Nuk i kam instrumentet për t'u përgjigjur në këtë pyetje. Po ndalem në atë që konstatoj në përvojën time dhe që vlenë për mua. Është një pohim i Chesterton që për mua është çarmastose: «E keqja nuk është se të dijshtimit nuk e shohin përgjigjen, por që nuk e shohin enigmen».⁵⁰ Kushti për të parë përgjigjen është që të shohim enigmen. Dhe kjo implikon një lloj sjellje përball realitetit, duke qëndruar të hapur që të provokohemi nga ajo, që të ndjekim sugjerimet, të gatshejmë për të pranuar ide dhe projekte dhe të mesojmë nga të gjithë ata që mund të na ndihmojnë. Pra, problemi është të mënyra se si e shikojmë realitetin, që ka të bëjë me të gjithë ne. Si dhe për lirin nga gabimet tona dhe nga spektri i përfitimeve (nga efekti që duam të arrijmë tek të tjerët). Kështu që ju mund të shërohemi më shpejt nga pengesa, nga dështimi, nga humbja, duke patur si timon të vetëm tensionin për të mirën e të gjithëve, asgjë tjetër.

⁵⁰ G.K. Chesterton, *Ortodossia*, Edizioni Martello, Milano 1988, p. 49.

Nese mundem: çfarë është duke të mbështetur më së shumti këto ditë?

Shpesh e kam parë si të dobishme që mos të tërhiqem nga sfidat që jeta nuk mi ka kursyer. Prandaj jam përballur edhe me këtë, i vëmendshëm për të zbuluar çfarë mund të lind nga një provokim që na zbulohet çdo ditë e më shumë në përmasat e saja të vërteta. Nuk kam mundur të qëndroja para asaj që ndodhte pa qenë i përshtetur nga habia për Pranin që dominon jetën time. Dhe përballë dobësisë që bëhet gjithnjë e më e dukshme në të gjitha aspektet e saj të ndryshme, rritej gjithnjë e më shume në mua pyetja: «Çfarë është njeriu që të kujtohesh për të, i biri i njeriut përse kujdesësh për të?».⁵¹

Dhe kjo Prani, ky Ti, të shoh sfidën që, se bashku me të tjerët, duhte të përballojë, duke më lejuar të jetoj si njeri friken që ajo na provokon, pa ikur nga drama, nga dhimbja, nga vdekja që shoh të ndodhe rreth meje që reagon në mua. Jam duke u munduar të jetojë të gjithë këtë si një rast për të verifikuar fen. Duke lejuar që të përfshihem nga pyetja që kjo situat ka sjell, i befasuar në mua – i habitur – një dritë për

⁵¹ Sal 8,5.

tu përballuar, ndiej gjithë arsyeshmërinë e qasjes që më sugjerohet nga feja.

Jeziusi e merr në zemër të gjithë njerzorën time dhe të të tjerëve. Jam duke kuptuar akoma më shumë se nga i vinte shën Palit ajo qartësi e pabesueshme, të cilën e kishte arritur pikrisht sepse nuk ishte kursyer nga asgje: «Kush, pra na ndan nga dashuria e Krishtit? Mbase tragjedia, ankthi, perndjekja, uria, lakuriqësia, frika, shpata? [...] po ne te gjitha keto gjera ne jemi me shume se fitimtar ne saje te ati qe na ka dashur. Në fakt, jam i bindur që as vdekja, as jeta, as engjëjt, as principatat, as e tanishmja, as e ardhmja, as fuqitë, as lartësia, as thellësia, as ndonjë krijesë tjetër nuk mund të na ndajë kurrë nga dashuria e Zotit, i cili është në Krishtin Jezus, Zotin tonë».⁵²

Njerzit që jetojnë me këtë qartësi janë shpresë për të gjithë - ashtu siç janë mbi të gjitha për mua këto ditë -, edhe për ata që ndjehën të brishtë përpara sfidës së virusit dhe janë largë fes së shën Palit. Njerz të tillë mund te ndezin dëshirën, për të pasur këtë fe, duke e kërkuar ne gjdo gjest të vogël ose të madhe, heroik, të ditës.

Kush nuk do të donte për vete këtë qartësi?

⁵² Rm 8,35-39.

Aq më tepër kur nuk e dim se si do te dalim nga kjo sfid jo vetëm nga aspekti shëndetësorë, por nga të gjitha pasojat tjera që pashmangshmërisht na presin. Vetëm me një qartësi të tillë më të vërtetë nuk do të mbesim të shurdhër ndaj thirrjes së rrethanave dhe të mos humasim rastin që të bëhemi më shumë vetja jonë, dhe më të dobishëm për të tjerët.

